

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Karakaci: Nisi ndërtimi i bypass të Elbasanit, zgjidhje e integruar gjithë pjesës së trafikut në Shqipëri
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/karakaci-nisi-ndertimi-i-bypass-te-elbasanit-zgjidhje-e-integruar-gjithe-i586299
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHË


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:44:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 16:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	61e7ef94bc9e6f165663445d789c76522c0c3760fe745e3f523375fe6c90a884
TEKSTI	4f01597901762f225eda020ffe8ecc77aa30db6d200af164e3331badd3cbb2d7
PAMJA	7f3a8d9ea4d753eab8d276d03bea77361e7471a488324f7e4d972f5cd90e64f5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	98098c79b6dbb48040e40fc1285012d7ee275480b1b7eab1f81bed73589e65c6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/98098c79b6dbb48040e40fc1285012d7ee275480b1b7eab1f81bed73589e65c6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Ish-zedhenesi i "Agimit te Arte" del nga burgu. Ilias Kasidaris paralajmëron rikthimin ne politike 24 ore para verdiktit Franca kerkon heqjen e sanksioneve per oligarkun fundit

Karakaçi: Nisi ndërtimi i bypass të Elbasanit, zgjidhje e integruar gjithë pjesës së trafikut në Shqipëri



15 Shtator 2026, 18:25 Sociale TEMA



anë nisur punimet për ndërtimin e bajpasit të Elbasanit, projekt që synon të përmirësojë qarkullimin dhe të lehtësojë trafikun në një prej akseve të rëndësishme rrugore të vendit. Ministri i Infrastruktūrës dhe Energjisë, Enea Karakaçi deklaroi gjatë inspektimit të punimeve, se segmenti do të ndërtohet si autostradë e kategorisë A, sipas standardeve të rrugës Tiranë-Elbasan.

"Kemi filluar punimet në bypassin e Elbasanit. Për ta konkretizuar është pjesa ku fillon hinka e autostradës Tiranë – Elbasan. Do të jetë autostradë e kategorisë A, sipas të njëjtave standardeve që është aktualisht sot rruga Tiranë-Elbasan.

I japim zgjidhje trafikut të krijuar gjatë gjithë kësaj periudhe dhe sidomos gjatë sezonit turistik. Dy kontratat janë lidhur tashmë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Segmenti i parë që fillon menjëherë aty ku përfundon rruga Tiranë – Elbasan tashmë ka filluar nga punimet.

Punimet janë duke ecur mirë për shkak se edhe kantieri është i hapur nga shpronësimit e bëra që më herët. Në këtë fazë jemi në 3 kilometrat e parë që përfundojnë diku te kombinati metalurgjik i Elbasanit, ndërkohë që kemi në prokurim po ashtu në vitin pasardhës pjesën vijuese deri afër Peqinit.

Pse ka rëndësi ky projekt? Kemi vazhdimin e autostradës Tiranë – Elbasan. Bëjmë ndarjen e trafikut ndërmjet pjesës juglindore të Shqipërisë dhe pjesës jugore të Shqipërisë, por po ashtu bëjmë ndërlidhjen ndërmjet autostradës Tiranë – Elbasan, bypassit të Elbasanit, si dhe dalim në vazhdimin e korridorit Elbasan – Qafë Thanë, duke i dhënë dhe një zgjidhje të integruar gjithë pjesës së trafikut në Shqipëri." u shpreh ai.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Prof. Dine Abazi, ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë](#)

15:32 Sociale

[Direct Media shënon 25 vjet në biznes/ Nga agjencia e parë mediatike deri te një lider rajonal në komunikimet e integruara](#)

13:01 Sociale

[Depistimi i fëmijëve në shkollë, ministrja Spahiu: Protokolle të qarta edhe për trajtimin në vijueshmëri](#)

11:35 Sociale

[Rama publikon pamjet nga rruga e Komanit: Transformim mes peizazhit spektakolar të veriut](#)

09:05 Sociale / 5 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.